L I G J
Nr.9550, datë 1.6.2006

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8408, DATË 25.9.1998 "PËR POLICINË E NDËRTIMIT"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8408, datë 25.9.1998 "Për Policinë e Ndërtimit", pas nenit 5 shtohet neni 5/a me këtë përmbajtje:

"Neni 5/a

Policia e Ndërtimit paguan taksë për veprimet që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor, në fund të ekzekutimit dhe në raport me shumën e ekzekutuar.".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4930, datë 16.6.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu